

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT
KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

T R A N S K R I P T

**NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË
17 DHE 21 NËNTOR 2005**

T R A N S K R I P T

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
17 I 21 NOVEMBRA 2005. GODINE**

Nëntor – Novembar

2005

RENDI I DITËS

Pjesa e parë:

1. Miratimi i Rezolutës për Kosovën Shtet të Pavarur dhe Sovran.

Pjesa e dytë:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Investimet e Huaja;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Dizajnin Industrial;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akreditimin;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Ushqimin;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Veprimtarinë Botuese dhe Librin;
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Institucionet e Kulturës;
8. Shqyrtimi i propozimvendimit për fillimin e procedurës për hartimin e Projekt-Kushtetutës së Kosovës;
9. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për Siguri;
10. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit Parlamentar ad hoc për t'i rekomanduar Kuvendit anëtarët e Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave;
11. Përgjigjja e Kryeministrit të Kosovës, deputetit Ramadan Kelmendi;
12. Përgjigjja e Kryeministrit të Kosovës, deputetit Berat Luzha.

ДНЕВНИ РЕД

Први део:

1. Усвајање Резолуције о Косову независна и суверена држава.

Други део:

1. Усвајање записника са претходне седнице;
2. Друго разматрање Нацрта закона за Стране Инвестиције;
3. Друго разматрање Нацрта закона за Индустијски Дизајн;
4. Друго разматрање Нацрта закона за Акредитацију;
5. Прво разматрање Нацрта закона за Храну;
6. Прво разматрање Нацрта закона за Издавачку делатност и књигу;
7. Прво разматрање Нацрта закона о Културним Институцијама;
8. Разматрање предлога одлуке за покретање процедуре о изради Нацрта Устава Косова;
9. Разматрање предлога за формирање Комисије за безбедност;
10. Разматрање предлога за формирање парламентарне Комисије, ад хоц, која би препоручила Скупштини чланове Савета за Независну комисију за медије;
11. Одговор Премијера Бајрам Косумија, посланику Рамадан Келменди;
12. Одговор Премијера Бајрам Косумија, посланику Берат Лужа.

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 17 NËNTOR 2005

Seancën plenare të Kuvendit, e kryesoi Akademik Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues, Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës.

Seanca u mbajt në Sallën plenare të Kuvendit, dhe filloi në orën 11,35.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Mirëmëngjesi, apo të themi edhe mirëdita. Mirëseardhje në Seancën plenare.

Besoj se të gjithë të pranishmit e kanë të qartë dhe na e arsyetojnë vonesën në hapjen e kësaj Seance.

T'ju informoj se në ndërkohë Kryesia mbajti dy takime. Po ashtu, edhe grupet parlamentare kanë pasur takime të veçanta.

Mund t'ju them se - duke falënderuar mirëkuptimin e të gjitha grupeve parlamentare, të udhëheqësve politik e partiak të grupeve parlamentare - është arritur marrëveshje e plotë për sa vijon:

Me propozim të grupeve parlamentare, edhe të udhëheqjes politike të tyre, formohet një Grup pune që, shpresojmë për një kohë të shkurtër, do ta harmonizojë tekstin përfundimtar, kurse ne, për një kohë të caktuar, ta presim kryerjen e punës së tyre.

Të them se përfaqësues të LDK, në këtë Grup pune, janë:

- **Profesor Fatmir Sejdiu dhe,**
- **Nekibe Kelmendi;**

Përfaqësues të PDK, janë

- **Zotëri Hashim Thaçi, dhe**
- **profesor Hajredin Kuçi;**

Përfaqësuese e Aleancës për ardhmërinë e Kosovës është

- **Gjylnaze Syla;**

Përfaqësues i ORA-s:

- **Ylber Hysa;**

Dhe përfaqësues i Grupit 6+

- **Mahir Yagcillar.**

Do ta lutja këtë Grup që të provojnë ta kryejnë punën deri në orën 14.

Prandaj, për këtë të kemi durim, t'i japim një kohë dyorëshe, e pastaj të vlerësojmë a mund të arrijmë me këto propozime dhe të vazhdojmë punën. Ju faleminderit.

Tani, do të bëjmë pauzë deri në orën 14.

(Vijoi pauza)

(Pas pauzës, Seanca vazhdoi punën në orën 15,05)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Besoj se mund të ulemi dhe - në mënyrë të qetë - të dëgjojmë rezultatin e punës 45 ditore, të pandërprerë, të komisioneve dhe të grupeve parlamentare.

T'ju informoj se pauza treorëshe ka qenë shumë e frytshme, për çka paraprakisht në mënyrë të veçantë i falënderoj për këtë.

Është arritur që të jetë një tekst unik në komisionin që ka punuar, i përkrahur nga të gjitha grupet parlamentare.

Besoj se na bën nderë që tekstin e Rezolutës, të adaptuar bashkërisht nga të gjithë, ta lexojë Nekibe Kelmendi, si avokate e njohur.

Prandaj, edhe më bën nderë që t'ia jap fjalën. Foltorja është e lirë për ju, Nekibe.

NEKIBE KELMENDI, anëtare e Grupit punues

I nderuari Kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe ju të pranishëm në këtë sallë të Kuvendit të Kosovës,

KUVENDI I KOSOVËS
Prishtinë, 17 nëntor 2005.

- Duke u mbështetur në Kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të drejtën e popujve për vetëvendosje dhe aktet tjera ndërkombëtare;
- Duke marrë parasysh aspiratën legjitime të popullit të Kosovës për të jetuar i lirë dhe në paqe me popujt tjerë;
- Duke u mbështetur në zhvillimet historike, juridike e kushtetuese të Kosovës, të shprehura në Konferencën e Bunjajt – 1943-1944; në Deklaratën kushtetuese të 2 korrikut të vitit 1990; në Referendumin e vitit 1991, si dhe në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran të vitit 1991;
- Duke u bazuar në luftën e gjatë të popullit të Kosovës për liri e pavarësi;
- Duke u bazuar në rezistencën e përgjithshme ndaj okupimit dhe në luftën e armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;
- Duke konfirmuar garantimin për mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve në Kosovë sipas standardeve ndërkombëtare;
- Duke u bazuar në programet e partive politike për statusin politik të Kosovës;
- Duke e çmuar lartë intervenimin e NATO-s në Kosovë për të ndalë gjenocidin dhe spastrimin etnik në Kosovë nga ana e Serbisë, si dhe ndihmën ndërkombëtare dhënë Kosovës,

Kuvendi i Kosovës, n x j e r r këtë

R E Z O L U T Ë

PËR RIKONFIRMIMIN E VULLNETIT POLITIK TË POPULLIT TË KOSOVËS PËR KOSOVËN SHTET TË PAVARUR DHE SOVRAN

1. Kuvendi i Kosovës, r i k o n f i r m o n vullnetin e popullit të Kosovës për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran;
2. Kuvendi i Kosovës, g a r a n t o n rikonfirmimin e vullnetit politik të popullit të Kosovës për pavarësi nëpërmjet të referendumit;

3. Kuvendi i Kosovës, m e r r obligim të nxjerrë kushtetutën e Kosovës në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian;
4. Kuvendi i Kosovës, k ë r k o n përkrahjen ndërkombëtare për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, si dhe nga vendet tjera;
5. Kuvendi i Kosovës, s h p r e h gatishmërinë që t'i ratifikojë të gjitha konventat dhe aktet e njohura ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut dhe mbi të drejtat e komuniteteve që dalin prej Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës dhe Organizatës për Siguri e Bashkëpunim Evropian;
6. Kuvendi i Kosovës, z o t o h e t për respektimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut për qytetarët e Kosovës dhe të drejtave të komuniteteve minoritare në pajtim të plotë me standardet ndërkombëtare;
7. Kuvendi i Kosovës, a n g a z h o h e t që Kosova të integrohet në strukturat Euroatlantike, mirëpret angazhimin e tyre të mëtejme në Kosovë dhe angazhohet për raporte të mira me vendet fqinje – duke kontribuar për stabilitetin e rajonit;
8. Kuvendi i Kosovës, g a r a n t o n tërësinë territoriale të Kosovës dhe pacenueshmërinë e kufijve të saj;
9. Kuvendi i Kosovës, k o n f i r m o n se vullneti i popullit të Kosovës për pavarësi është i panegociueshëm;
10. Kuvendi i Kosovës, duke mbështetur Delegacionin e Kosovës, do të përcjell gjithë procesin e punës së tij dhe çdo vendim për të ardhmen e Kosovës do të ratifikohet në Kuvend apo nëpërmjet të referendumit.

Kjo Rezolutë, paraqet bazë juridike dhe politike për platformën e Delegacionit të Kosovës për pavarësinë e Kosovës.

Ju faleminderit.

(Duartrokitje të pandërprera nga të gjithë deputetët e Kuvendit)

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Më lejoni t'ju falënderoj për punë shumë të suksesshme.

T'ju them se të pranishëm në sallë janë 104 deputetë.

Dhe, si gjithmonë, gjatë çdo vullneti të mirë, çdo sukcesi dhe çdo ndjenje të lumturisë dhe kënaqësisë – jeta sjell edhe vështirësi dhe probleme.

Kemi një lutje që, për gjysmë minute, ta dëgjojmë Sabit Rrahmanin, deputet i hashkalijve që mbrëmë patën një tragjedi – një familje është djegur.

Sabit, urdhëroni, foltorja është e lirë për ju.

SABIT RRAHMANI

Ju faleminderit zoti Kryetar.

I nderuar Kryeministër, të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar, të nderuar deputetë dhe të nderuar mysafirë të pranishëm,

Meqenëse rastin e keni të njohur se si ka ndodhë, dhe edhe sot pjesëtarët e komunitetit hashkali kanë ditë zie, duke marrë parasysh rëndësinë e kësaj Seance të jashtëzakonshme, duke marrë parasysh procesin nëpër të cilin po kalon Kosova, vetëm desha ta konfirmoj votën time pro kësaj Rezolute dhe pro vullnetit të popullit të Kosovës, e po ashtu edhe të falënderoj edhe Kryeministrin i cili i ka ofruar sot një ndihmë, nga Kabineti i tij qeveritar, familjes Tartari.

Mendojmë se edhe institucionalisht, institucionet e Kosovës do ta ndihmojnë atë familje. Dhe, meqenëse ne jemi në përgatitje të varrimit të asaj familje, unë tash do ta lëshoj sallën, sepse edhe nuk kemi kohë më tepër. Prandaj, vetëm konfirmoj votën time pro kësaj Rezolute dhe kjo votë e imja, mund të numërohet pro. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Faleminderit. Unë ju falënderoj për këtë punë të mirë sot.

Pjesa tjetër e punës së Seancës, vazhdon të hënën në orën 10.

Ju faleminderit shumë.

(Puna e seancës, më 17.11.2005, përfundoi në orën 15,15).

(Seanca vazhdoi punën më 21 nëntor 2005, në orën 10,00)

MBLEDHJA PLENARE

E hënë, më 21.11.2005

Ora 10,00

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju dëshiroj mirëseardhje në pjesën e dytë të seancës që e kishim filluar, mirëseardhje deputetëve dhe ministrit Dugolli.

1. Në rend dite është miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Unë do të sugjeroja që me shkrim t'i japin vërejtjet, në qoftë se i ka dikush të shkruara, megjithatë, nëse deputetët e ndiejnë të nevojshme edhe prononcimin gojor. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për investime të huaja

Konstatimet hyrëse, miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 24 qershor 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente.

Unë dua të ju informoj që propozuesi i ligjit ka mendim që gjatë amendamentimit komisioni në disa raste, në një mënyrë ose tjetër e ndryshon propozimin e draft ligjit që është aprovuar në shqyrtim të parë. Prandaj janë dy mundësi, nuk ka kërkuar propozuesi që të hiqet, por unë do të doja që komisioni para se t'i hyjmë shqyrtimit, ta dimë mendimin e komisionit. Në parim, ju lutem, kemi dy- tre raste që po ngjajnë kështu. I ftoja gjithmonë komisionet funksionale dhe propozuesin që ta sqarojnë këtë në mënyrë që të mos futemi në diçka të paqartë dhe të krijojmë një ligj që nuk është i mirë. Urdhëro, ministër Bujar Dugolli.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI

Faleminderit z. Kryetar,

Është fjala për atë që e kemi kaluar këtë ligj në Parlament në mënyrë unanime. Gjatë shqyrtimit dhe votimit të amendamenteve, unë do të kërkoj nga deputetët që disa amendamente të mbesin si është në ligj. Por, është e drejtë e Kuvendit që të vendos me

votën e tyre. Konsiderojmë që është me rëndësi që ligji t'i kalojë procedurat sa më shpejtë dhe të nënshkruhet nga përfaqësuesi special. Qëllimi është i mirë që ligjin ta kalojmë sa më shpejtë. Unë nuk po kërkoj që ta heqim, por do të reagoj në disa amendamente kur mendoj që duhet të mbesin në rast se deputetët e shohin të arsyeshme, në rast se jo, unë do të pres që ndoshta edhe përfaqësuesi special do ta kalojë ashtu siç e kalojmë ne. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Urdhëro, Fatmir Rexhepi

DEPUTETI FATMIR REXHEPI:

I nderuari kryetar,
të nderuar kolegë deputetë,. Ministra,

Komisioni funksional këtij Projektligji i ka kushtuar një vëmendje të veçantë, ka kaluar një kohë e gjatë nga leximi i parë. E kemi shqyrtuar me muaj të tërë në bashkëpunim me zyrën ligjore dhe me ekspertë edhe nga zyrat e jashtme edhe nga vendorët. Kemi ofruar këto alternativa përmes amendamenteve që i keni para veti. Kjo paketë e amendamenteve na ka marrë bukur shumë kohë, të them edhe debate brenda komisionit. Edhe mendimet dhe vlerësimet që i kemi dhënë tash është vështirë në qoftë se ndonjë amendament është i veçantë dhe nuk ka të bëjë me amendamentet që janë dhënë njeri pas tjetrit dhe që ndërlihen. Nuk është problem që t'i trajtojmë këtu dhe ta shohim se a i votojmë apo jo, por unë mendoj që shumica e tyre janë me vend dhe është kërkuar mendim edhe nga ana e ekspertëve që të shihet nga syri i investitorëve të huaj dhe si do të duket ky Projektligji për investitorët e huaj. Këtu pra është fokusuar më shumë komisioni. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit, atëherë vazhdojmë në bazë të raporteve të komisioneve kryesore.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI

Ju faleminderit z. kryetar,
Ne të gjithë e dimë që këtu nuk ndërrohen amendamentet. E dimë si është procedura, kështu që nuk mendoj se duhet bërë përjashtim këtu, aq më pak kur ne me të vërtetë me përkushtim si komision funksional e kemi analizuar dhe janë këto amendamentet që janë. Dihet se nëse ndërrohet një amendament, mund të ndërrojnë shumë tjerë për hir të tij dhe ne nuk jemi në gjendje këtu të përcaktojmë se çka mund të ndërrojë, çka nuk mund të ndërrojë. Prandaj, unë mendoj që kjo nuk duhet të vijë në shprehje. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Unë mendoj që duhet të pajtohemi në tërësi me mendimin e Bajrushit. Në qoftë se hyjmë në procedurë dhe një amendament e aprovojmë e tjetrin jo, edhe pse njëri me tjetrin janë organikisht të lidhur, s'është mirë. Prandaj, unë thash se jam i mendimit që ta shtyjmë për

seancën e ardhshme në mënyrë që propozuesi dhe komisioni funksional edhe një herë t'i harmonizojnë qëndrimet. Ku kemi pritur deri më tash, mund të presim edhe pak. Unë mendoj që kryetari duhet kësaj radhe të pajtohet, por po ua jap fjalën edhe njëherë.

DEPUTETI FATMIR REXHEPI

Zoti kryetar, ne mund të merremi vesh se cila alternativë është më e mirë, por unë mendoj që me paketën e amendamenteve ne e kemi dhënë edhe komentimin shpjegues për çdo amendament. Çdo deputetë mund t'i vlerësojë amendamentet në projektligj dhe amendamentet e reja. Mendoj që mund ta kalojmë projektligjin sot, sepse është bërë një punë e madhe. Vetëm në qoftë se ka ndonjë rast të veçantë, pajtohemi me te, sepse ndonjë amendament është i veçantë sikur që ndoshta është vërejtja lidhur me masat stimulative që është bërë edhe nga ana e deputetit. Ne mund ta trajtojmë atë dhe ta shohim a është objekt që mund të ndahet nga paketa. Përndryshe, të tjerat unë mendoj që mund të shkojnë në pjesën e votimit ashtu siç janë paraparë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Profesor Alush Gashin unë do ta lutja për ndihmë.

DEPUTETI ALUSH GASHI

I nderuari z. kryetar, ne punojmë sipas një Rregulloreje të Kuvendit të Kosovës. Në leximin e parë, në parim ky Projektligj ka kaluar, ne nuk jemi duke përgatitur tekste që i pëlqejnë ose si pëlqejnë ministrit. Ministri ka pasur mundësi që në kuadër të procedurave t'i ngrejë të gjitha çështjet para komisionit funksional. Komisioni funksional na i ka dhënë amendamentet dhe ju lutem që të procedoni sipas Rregullores dhe ato amendamente sot të kalojnë apo të refuzohen. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Gani Koci, urdhëro!

DEPUTETI GANI KOCI

Zoti Kryetar, nuk desha të shtoj më shumë, atë e kisha që e tha Bajrush. Ne vërtet kemi aplikuar këtu një praktikë të miratimit të ligjeve dhe ministri ka pasur kohë të shqyrtojë dhe të sugjerojë rreth amendamenteve të Komisionit kryesor që e ka shtruar këtë çështje.

Ne nëse shkojmë tash me komente të çdo amendamenti, atëherë do ta fusim këtë praktikë të re dhe kemi ndoshta çka të themi për secilin amendament që e ka propozuar edhe vetë Komisioni.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit, por nuk e mbështete propozimin e Bajrushit. Për ta pasur të qartë, urdhëro ministër!

MINISTRI BUJAR DUGOLLI

Ju faleminderit z. Kryetar. Normalisht, mua më lejohet e drejta që në raste të veçanta ta tërheq ligjin, por unë nuk kërkova ta tërheq ligjin. Ne i kemi diskutuar në komisione disa nene që është paraparë të hiqen e unë mendoj që nuk duhet të hiqen. Në rast se Kuvendi me votën e vet vendos të mbeten, unë pajtohem me atë. Pra, nuk jam duke bërë asnjë veprim që dikush mund ta cilësojë se nuk kemi qenë në konsultim me komisionin. Ne kemi qenë në konsultim me komisionin për të qenë ligji sa më komplet. Unë mendoj që disa nene që janë paraparë të hiqen, e që nuk bien ndesh me nenet e tjera, duhet të mbesin. Për këtë do të japë vlerësimin edhe kryetari i Komisionit, kur unë e kërkoj këtë.

Në rast se deputetët nuk donë ta përfillin këtë, le ta votojnë ashtu si është. Unë nuk jam kundër, por të vazhdojmë me procedim të amendamenteve ashtu siç i ka paraqitur komisioni. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Ministër, ju faleminderit. Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për ekonomi, tregti, industri, energjetikë, transport dhe telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Departamenti për mbështetje ligjore dhe procedurale ka bërë radhitjen e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për investime të huaja.

Komisioni për çështje gjyqësore, legjislacion dhe Kornizë kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për investime të huaja ka bazën juridike në Kornizën kushtetuese, Komisioni për buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për investime të huaja dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për investime të huaja dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat e interesat e komuniteteve.

Amendamenti 1

Rekomandimet e Komisionit funksional.

Lus regjinë që të përgatitemi për votim.

Do të thotë, përgatitemi për votim. 83 deputetë janë në sallë, votojmë tani:

-61 deputetë janë për.

Konstatoj se u miratua amendamenti 1. Ju faleminderit!

Amendamenti 2

Përgatitemi për vendimmarrje dhe votojmë tani:

-72 deputetë janë **për**.

Konstatohet se u miratua amendamenti 2.

Amendamenti 3

88 deputetë janë në sallë. Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

-79 deputetë janë **pro**.

Konstatohet se u miratua amendamenti 3.

Amendamenti 4

Përgatitemi për vendimmarrje dhe votojmë tani:

-69 deputetë janë **për**.

Konstatohet se u miratua amendamenti 4.

Amendamenti 5

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

-76 deputetë janë **për**.

Konstatohet se u miratua amendamenti 5.

Amendamenti 6

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

-69 deputetë janë **për**.

Konstatohet se u miratua amendamenti 6.

Amendamenti 7

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

-74 deputetë janë **për**.

Konstatohet se u miratua amendamenti 7.

Amendamenti 8

Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:

-67 deputetë janë **për**.

Konstatohet se u miratua amendamenti 8.

Amendamenti 9

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

-74 deputetë janë **për**.

Konstatohet se u miratua amendamenti 9.

Amendamenti 10

Përgatitemi për votim, votojmë tani:

-72 deputetë janë për.
Konstatohet se u miratua amendamenti 10.

Amendamenti 11
Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:
-69 deputetë janë për.
Konstatohet se u miratua amendamenti 11.

Amendamenti 12
Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:
-70 deputetë janë për.
Konstatohet se u miratua amendamenti 12.

Amendamenti 13
Ministri e ka fjalën, urdhëroni z. ministër!

MINISTRI BUJAR DUGOLLI

Unë mendoj që këtu është paraparë të fshihet teksti që është dhënë në Projektligj. Edhe pse ne e dimë shpjegimin që e ka dhënë komisioni, mendoj që neni 11 që ka të bëjë me mbrojtjen e ambientit jetësor duhet të ekzistojë edhe në këtë ligj. Nuk është duplikim, sepse investitorëve e huaj ndoshta më shumë do t'u hynte në punë Ligji për mbrojtjen e investimeve të huaja dhe më shumë do ta konsultonin. Ai parasheh që të jetë i obliguar dhe të respektoj dhe ligjet e tjera. Mendoj që mund të jetë ky tekst sepse nuk bie ndesh me nenet e tjera dhe do të kisha kërkuar që të mbetet ky nen si është në ligj.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ftojë kryetarin e Komisionit të japë mendimi e vet.

DEPUTETI FATMIR REXHEPI

Bazuar në vlerësimet tona, ne e kemi parë të udhës që t'i i shkurtuajmë dhe të mos i përmendim në tërë projektligjin, do të thotë të mos renditen të gjitha ligjet. Kjo ka qenë arsyeja që e kemi shkurtuar tekstin, pra për ta bërë më racional. Përndryshe, qëndron kjo që e tha ministri. Nuk ka diçka të veçantë, por ne me një vlerësim tonin kemi shkuar në shumë nene, pra i kemi shkurtuar dhe e kanë edhe këtë bazë që është këtu, do të thotë të mos përsëriten.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Unë po bindem që komponenta e mjedisit ose e ambientit është më mirë të jetë ashtu si thotë Qeveria, sepse është ligj për investimet e huaja dhe në një mënyrë ose tjetër i obligojmë të tjerët. Urdhëro Bajrush!

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAJLI

Neve nuk na prish punë kjo. Këtë në të vërtetë e tha edhe kryetari, por duhet të pajtohemi me kryetarin. Pra, të informojë dhe ta përforcojë më tepër atë se ne e kemi shqyrtuar këtë dhe kjo përmendet jo njëherë po disa herë. Ne kemi menduar më racionalist, përndryshe nuk na prish punë nëse është dakord ministri dhe ky Kuvend.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Unë do të thoja dhe rekomandoja që të mbetet ajo që e kemi votuar në lexim të parë. Megjithatë, është kjo çështje e deputetëve. Kryetari i Komisionit dhe nënkryetari i thanë mendimet personale dhe të komisionit. Ajo që e kanë bërë është mirë, por nuk janë edhe kundër versionit në shqyrtimin e parë, do të thotë propozimit të Qeverisë. Unë do të votoj për versionin e Qeverisë, sepse vetëm e shton vlerën për investimet e huaja, mbrojtja e mjedisit nuk ka asgjë të keqe. Ose të themi tërhiqet amendamenti dhe mbetet si është në ligj, nuk votojmë fare. Ju faleminderit!

Nekibe Kelmendi, urdhëroni!

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI

Për hir të asaj që të qartësohet kjo situatë që është krijuar, do të ishte mirë që kryetari i Komisionit të dalë dhe të deklarohet, jo me presion, por nëse e tërheq amendamentin, atëherë s'kemi çka të votojmë.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Fatmir Rexhepi, urdhëroni ju lutem!

DEPUTETI, FATMIR REXHEPI

Zoti Kryetar, të marrim për bazë shpjegimet që u dhanë edhe nga ana e ministrit, edhe nga ana e juaj, kështu që mendoj që kjo le të mbetet ashtu siç është në Projektligj. Pra, ne e tërheqim amendamentin tonë.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ju faleminderit shumë, kalojmë në amendamentin 14.

Amendamenti 14

Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:

-67 deputetë janë **pro**.

Konstatojë se u miratua amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Përgatitemi për vendimmarrje, 91 deputetë janë në sallë, votojmë tani:

-68 deputetë janë për.
Konstatohet se u miratua amendamenti 15.

Amendamenti 16
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
-74 deputetë janë për.
Konstatohet se u miratua amendamenti 16.

Amendamenti 17
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
-68 deputetë janë për.
Konstatohet se u miratua amendamenti 17.

Amendamenti 18
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
-71 deputetë janë për.
Konstatohet se u miratua amendamenti 18.

Amendamenti 19
Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:
-72 deputetë janë për.
Konstatohet se u miratua amendamenti 19.

Amendamenti 20
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
-75 deputetë janë për.
Konstatohet se u miratua amendamenti 20.

Amendamenti 21
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
-76 deputetë janë për, por ju lutem, një numër i konsiderueshëm i deputetëve nuk po voton. Kartelat janë të vendosura dhe mund të përcillen votimin “kundër” dhe “abstenon”. Unë do të ceku se kjo si parim është e drejtë juridike, por po e shoh që nuk po përputhen votat.
Konstatohet se u miratua amendamenti 21.

Amendamenti 22
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
-75 deputetë janë për.
Konstatohet se u miratua amendamenti 22.

Amendamenti 23
Përgatitemi për votim, votojmë tani:
-76 deputetë janë për.

Konstatohet se u miratua amendamenti 23.

Amendamenti 24

MINISTRI BUJAR DUGOLLI

Po ashtu, kërkesa është që të mbetet ky amendament ashtu si është e paraparë me ligj. Ne e kemi diskutuar këtë në Qeveri dhe kur të bëhet ligji për investimet e huaja duhet të parashohim edhe disa masa stimuluese. Për momentin ekzistojnë vetëm këto ligje, apo rregullore të UNMIK-ut, që garantojnë në një masë stimuluese dhe ne nuk kemi ligje të tjera të veçanta. Unë mendoj se në ligj duhet të parashihet kjo derisa ne të kemi mundësi të aplikojmë masat të tjera stimuluese për investimet e huaja, në Qeveri ka kaluar kjo dhe le të mbetet. Mendoj që është e nevojshme të mbetet kjo, por le të vendos komisioni. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Kryetari i Komisionit.

DEPUTETI FATMIR REXHEPI

Vlerësimi ynë ka të bëjë me atë se edhe investitorët e huaj duhet të kenë trajtimin e njëjtë si edhe investitorët vendorë. Në pikën 4.3, në amendamentin 4 thuhet se investitorët e huaj edhe investimet e tyre duhet të jenë në pajtim të plotë me ligjin e zbatueshëm në Kosovë dhe i bartin të drejtat dhe detyrimet njëllor si edhe investitorët e brendshëm dhe investimet e tyre, prandaj ne nuk kemi pasur nga këndi ynë ndonjë përvojë deri tash se si janë ato, por ka mbisunduar vlerësimi që të jenë kushtet e njëjta si për investitorët e huaj, ashtu edhe për investitorët vendorë në lidhje me investimet në Kosovë. Këtë e kemi bërë në konsultim edhe me ekspertët që kanë punuar në projektligje në faza të tranzicionit në vendet e tjera. Nuk është ndonjë vendim personal i yni, por vërtet nuk kemi arsye sepse nuk janë më të çmueshëm investitorët vendorë se investitorit të huaj. Pra, kur investohet në një projekt, është me rëndësi efekti financiar.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Megjithatë, unë do të lusja deputetët dhe si parim ta dimë se të gjitha vendet që janë në zhvillim dhe kanë nevojë për riaktivizimin e resurseve të veta, është mirë që brenda kufijve të mundshëm natyror dhe ligjor të kenë lehtësira të tilla dhe unë do të thosha se propozimi i Qeverisë është ajo që i duhet Kosovës. Ne do të votojmë, është e drejtë e deputetëve kjo. Do të thotë, komisioni ka punuar mirë, vlerësojmë që duhet të jenë në një plan të gjithë investitorët. Unë po ju bind që ne e ndihmojmë vetveten, e ndihmojmë ekonominë tonë në qoftë se arrijmë të sigurojmë investitorë të duhur për projekte të mëdha zhvillimore.

DEPUTETI BAJRUSH XHEMAI

Ne mund ta aprovojmë cilëndo formë, është kjo e drejtë e këtij Kuvendi, por ta dimë që bien në kundërshtim me disa nene, jo vetëm me një. Nenin 4.3 ne vërtet e kemi analizuar, ka qenë edhe përfaqësuesi i ministrisë dhe të gjithë kemi qenë në dakord si komision, prandaj unë mendoj që duhet të mbetet si është në amendamentin 24. Unë mendoj megjithatë se edhe investitorët vendorë duhet të jenë me një plan dhe kjo është e mjaftueshme siç është amendamenti. Le të mos bëjmë nene kundër neneve sepse duhet t'i nderrojmë edhe dy tri nene të tjera nëse vendosim kështu, prandaj nuk është mirë të veprojmë në këtë mënyrë. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Do ta qes në votim, është e drejtë e deputetëve. Unë po ju them se drejta e kualitetit nuk realizohet askund në vendet që kanë nevojë për investime të huaja. Gjithmonë gjithkund kërkohen lehtësime të mundshme pa e prishur bilancin. Por, është e drejtë të hyjmë në procedurë. Kjo ishte arsyeja që unë kërkova që në fillim ta hiqim nga procedura dhe të lenim kohë, sepse një amendament lidhet me të tjerët. Tash jemi nga fundi, kemi edhe 6 amendamente dhe ndoshta do të ishte mirë të kemi mirëkuptim për propozimin e Qeverisë, jo pse Komisioni ka punuar keq.

Hyjmë në procedurë, jemi nga fundi, është e drejtë e deputetëve, andaj le të përgatitet regjia për vendimmarrje. Çdo deputetë e ka vendimin e vet, prandaj votojmë tani:

-52 janë për.

Konstatohet se u miratua amendamenti 24.

Amendamenti 25

Amendamenti 25 është pa përkrahje nga komisioni.

Përgatitemi për votim:

Gjylnaze Sylja, urdhëroni!

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

Ju faleminderit z. Kryetar: Unë e di që Komisioni ka punuar, megjithatë mendoj që ky nen duhet të përkrahet dhe kërkoj përkrahjen e kolegëve të mi. Më lejoni t'ju sqaroj argumentet e mia. Mendoj që për zhvillimin tonë ekonomik është shumë e rëndësishme dhe e nevojshme tërheqja e kapitalit të huaj dhe investimet direkte, sidomos kur merret parasysh që kjo krijon vende të reja të punës, po ashtu rrit zhvillimin teknologjik, por rrit edhe buxhetin e shtetit.

Qëllimi i këtij amendamenti ka qenë që të krijohen kushtet në Kosovë për tërheqjen e kapitalit të huaj, duke marrë parasysh sidomos konkurrencën në vendet përreth, siç është thënë në vendet e rajonit në Mal të Zi dhe Maqedoni. Sipas ligjeve ekzistuese që kemi për investimet e huaja, një ndërmarrje që dëshiron të bëjë biznes në Kosovë duhet të llogarisë me pagesën e tatimeve në fitime deri në 40%, gjë që tejkalon rajonin ,edhe nivelin evropian, prandaj ne duhet t'u krijojmë kushte investitorëve të huaj të vijnë dhe të investojnë këtu, për arsye se në situatën në të cilën ndodhemi as nuk kemi investime të kapitalit, as punësim të ri , e me këtë as rritje të buxhetit. Sikur të kishim kapital vendor, nuk do të kishim nevojë të kishim një ligj për tërheqjen e kapitalit të huaj, por me qenë se kapitali vendor nuk e ka atë që e kanë ndërmarrjet e mëdha, atëherë duhet krijuar lehtësira tatimore për ta. Ky ka qenë qëllimi im. Ju faleminderit!

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Propozuese e amendamentit, ju faleminderit. Për këtë arsye unë kërkova përkrahjen e amendamentit të mëparshëm sepse ai do ta kishte zgjidhur edhe këtë, po ai e kaloi tashmë, kështu që në qoftë se ne e votojmë tash si po thoni ju, do të hyjmë në kundërshtim me amendamentin e mëparshëm. Megjithatë, a është ky propozim individual, apo i grupit parlamentar?

DEPUTETJA GJYLNAZE SYLA

Është propozim imi, por e kam përkrahjen e grupit parlamentar.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

I dëgjuam propozimet dhe arsyetimet. Përgatituni për të votuar, votojmë tani:

-30 vota janë për,

-54 vota janë kundër.

Konstatohet se amendamenti nuk miratohet.

Amendamenti 26

Përgatituni për të votuar, votojmë tani:

-74 deputetë janë për.

Konstatohet se u miratua amendamenti 26.

Amendamenti 27

Përgatituni për të votuar, votojmë tani:

-70 deputetë janë për.

Konstatohet se u miratua amendamenti 27.

Amendamenti 28

Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:

-75 deputetë janë për.

Konstatoj se u miratua amendamenti 28.

Amendamenti 29

Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:

73 deputetë janë për.

Konstatoj se u miratua amendamenti 29.

Amendamenti 30

Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:

-66 deputetë janë për.

Konstatoj se u miratua amendamenti 30.

Amendamenti 31

Përgatitemi për të votuar, votojmë tani:

-74 deputetë janë për.

Konstatoj se u miratua amendamenti 31.

Tani ju lutem që të përcaktohem për aprovimin dhe votimin e Ligjit në tërësi me amendamentet e aprovuara sot.

Përgatitemi për vendimmarrje dhe votojmë tani.

90 deputetë janë në sallë.

79 deputetë kanë votuar për, konsideroj se ligji është aprovuar.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dizajnin industrial.

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë me 25 korrik 2005. Komisionet parlamentare i kanë shqyrtuar dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet e tyre.

Në bazë të raporteve të këtyre komisioneve, të atij kryesor dhe Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Komunikacion, si Komision funksional dhe raportues, Departamenti përkatës në vijim ka bërë radhitjen e komandimeve dhe amendamenteve. Komisioni për Çështje Gjyqësore dhe tjera ka vlerësuar se Projektligji për dizajnin industrial ka bazën juridike në Kornizën kushtetuese. Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për dizajnin industrial dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e

Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për dizajnin industrial dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Amendamentet dhe rekomandimet e komisionit funksional.

Amendamenti 1

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

69 deputetë janë **për**.

Ka kaluar amendamenti 1.

Amendamenti 2

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

69 deputetë janë **pro**.

Ka kaluar amendamenti 2.

Amendamenti 3

Përgatitemi për vendimmarrje dhe votojmë tani:

76 deputetë janë **për**.

Ka kaluar amendamenti 3.

Amendamenti 4

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

75 deputetë janë **pro**.

Ka kaluar amendamenti 4.

Amendamenti 5

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

71 deputetë janë **pro**.

Kalon amendamenti 5.

Amendamenti 6

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

68 deputetë janë **për**.

Kalon amendamenti 6.

Konsideroj se edhe amendamenti i fundit është aprovuar dhe tani ju ftoj që ta votojmë Ligjin në tërësi me amendamentet e aprovuara.

Bëhemi gati për të votuar dhe votojmë tani:

72 deputetë kanë votuar **për**, do të thotë është aprovuar Ligji në tërësi.

Kalojmë në pikën e radhës në qoftë se ka aq dritë nga mikrofonit që mund ta lexoj.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për akreditimin

Miratimi në parim i këtij Projektligji është bërë më 25 korrik 2005. Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet e tyre. Në bazë të këtyre raporteve komisioneve kryesore dhe Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetik, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, Departamenti përkatës ka bërë radhitjen e rekomandimeve dhe amendamenteve në Projektligjin për akreditim.

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për akreditim ka bazën juridike në Kornizën kushtetuese. Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligji për akreditim dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për akreditim dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Amendamentet dhe rekomandimet janë të komisionit funksional.

Amendamenti 1

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

73 deputetë janë për **pro**.

Ka kaluar amendamenti 1.

Amendamenti 2

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

74 deputetë janë për.

Ka kaluar edhe amendamenti 2.

Amendamenti 3

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

67 deputetë janë për.

Ka kaluar amendamenti 3.

Amendamenti 4

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

73 deputetë janë **pro**.

Ka kaluar amendamenti 4.

Amendamenti 5

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

Duhet ta përsërisë, ju lutem, keni filluar prej Sabri Hamitit që s'është këtu e tutje mos me ndëgju as propozimin e as me votua.

Kanë votuar gjithsej 39 veta, prej 90-të sa janë të pranishëm. Teknika i ka fajet, prandaj e përsërisim.

Amendamenti 5

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

73 deputetë janë **për**.

Ka kaluar amendamenti 5.

Amendamenti 6

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

71 deputetë janë **pro**.

Ka kaluar amendamenti 6.

Amendamenti 7

Përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

74 deputetë janë **pro**.

Ka kaluar amendamenti 7.

Amendamenti 8

Dhe i fundit, përgatitemi për të votuar, votojmë tani:

69 deputetë janë **për**.

Ka kaluar edhe amendamenti 8.

E tani ju ftoj që të përgatitemi për ta votuar ligjin në tërësi. Edhe Alushi edhe Fatmiri përfshihen në këtë. Ju faleminderit.

Prandaj përgatitemi për votim dhe votojmë tani:

73 deputetë janë **për**, prandaj konsideroj që është aprovuar Ligji me amendamentet e aprovuara.

Tani ndërrohet pak përmbajtja e vazhdimet. Ka një mundësi që të shkojmë tani në pauzë, por unë e di që një pjesë e madhe e deputetëve para orës 12,00 do ta lëshojnë seancën, ose të punojmë edhe pak, edhe një ligj në shqyrtim të parë, të vazhdojmë edhe shqyrtimin e parë të një ligji. Ju faleminderit, ta vazhdojmë, pika e radhës është

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ushqimin

Projektligji është u shpërndarë deputetëve me 15 shtator 2005 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'ia adresohen për shqyrtim komisionit funksional përgjegjës për raportimin dhe komisioneve kryesore.

Ftohet zëvendësministri Tom Hajdaraj që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Ligjin.

Z. zëvendësministër urdhëroni.

ZËVENDËSMINISTRI TOM HAJDARAJ

Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë, i nderuari z. Dugolli. Shkurtimisht para jush po bëj prezantimin e Projektligjit për ushqimin duke filluar që nga nevoja për nxjerrjen e tij e tutje. Duke u nisur nga rëndësia e kontrollit të cilësisë së ushqimit dhe ushqimit të sigurt për shëndetin e njerëzve dhe shëndetin e kafshëve, respektivisht duke pasur parasysh rëndësinë e ushqimit të sigurt për ruajtjen e shëndetit publik në Kosovë e në mungesë së legjislacionit në këtë fushë është e domosdoshme nxjerrja e Ligjit për ushqimin dhe kompletimi i infrastrukturës ligjore për ushqimin.

Ky Projektligj është i harmonizuar me legjislacionin e bashkësisë evropiane dhe me standardet ndërkombëtare për ushqimin. Përveç kësaj është e nevojshme edhe krijimi i autoriteteve që do të merren me çështjen e sigurisë së ushqimit me prejardhje shtazore dhe bimore si dhe përcaktimi i kompetencave të atyre autoriteteve në fushën e sigurisë së ushqimit.

1. Qëllimi kryesor i nxjerrjes së këtij Ligji është krijimi i kornizës ligjore për parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me higjienën, sigurimin e ushqimit për shëndetin publik dhe ushqimin e sigurt për kafshët.

2. Arritja e objektivave të përgjithshme për një siguri më të madhe të qytetarëve të Kosovë që si konsumatorë të jenë plotësisht të sigurt sa i përket sigurisë së ushqimit. Ky ligj ka shtrirjen e të gjitha fazat që nga prodhimi, përpunimi, deponimi dhe distribuimi i ushqimit për njerëz dhe i ushqimit për kafshët. Pra qëllimi kryesor i këtij Ligji është të siguroarit e qytetarëve të Kosovës se ushqimi që prodhohet, përpunohet, importohet, tregtohet dhe konsumohet në Kosovë është i sigurt për çka edhe do të kryhen mbikëqyrjet inspektuese me qëllim evitimit të ekzistimit eventual të çfarëdo parregullsie lidhur me afarizmin në ushqim. Çështjet kryesore të cilat i rregullon ky ligj janë të shtrira në XIV kapituj duke filluar nga dispozitat e përgjithshme e parimet e përgjithshme të analizës së rrezikut përmbajtjen e dispozitat e ushqimit të sigurt rregullon kushtet e përgjithshme dhe specifike të higjienës të ushqimit, pastaj dispozitat për ushqim të ri dhe organizmat e modifikuar gjenetiksht, përmban dispozitat të cilat rregullojnë deklarinimin e ushqimit i cili është i plasuar në treg e dispozitat që cilat rregullojnë kontrollin zyrtar të ushqimit të sigurt higjieno-ushqimit e tjera, rregullon mënyrën dhe metodat e punës për secilën analizë që bëhet për kontrollin zyrtar të ushqimit, përmban dispozitat për mënyrën e menaxhimit me kriza në raste emergjente për sigurimin e ushqimit të sigurt në planin e përgjithshëm, rregullon kërkesën lidhur me ushqim të sigurt për kafshët që i reflektohen aditivëve për ushqim . Kapitulli XI rregullon çështjen e krijimit të trupit i cili do të kryen të gjitha punët menaxhuese konform këtij ligji. Kapitulli XII përmban dispozitat ndëshkimore në rast mos përmbajtjes të këtij ligji dhe dispozitat përfundimtare. Përveç këtyre kapitujve. Ky ligj ka edhe aneksin e tij në të cilën janë theksuar artikuj ushqimor që është përcaktuar për kompetenca të inspektorëve se kush çka duhet të kontrollojë.

Ky Ligj është hartuar nga ekspertët e Ministrisë, Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Shëndetësisë dhe është mbështetur nga ekspertët ndërkombëtar dhe vendor për të angazhuar nga Organizata Botërore e Ushqimit. Gjatë fazës së shqyrtimit të këtij Projektligji janë kyçur institucionet të ndryshme nga kjo lami, sidomos Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Shërbimeve Publike, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Zyra ligjore USAID-it dhe Zyra Ligjore e Kryeministrit. Gjatë hartimit të këtij ligji janë shfrytëzuar edhe përvojat e shteteve në Bashkimin Evropian. Duke pasur parasysh rëndësinë që ka ky Ligj dhe qëllimin e nxjerrjes së tij, ju kisha ftuar që sot në parim Parlamenti i Kosovës ta miratojë këtë projekt. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Zëvendësministër ju faleminderit. Hapim debatin në parim dhe ftoj Lulzim Zenelin në emër të LDK-së Urdhëroni Lulzim.

DEPUTETI LULZIM ZENELI

Faleminderit z. kryetar. I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë, i nderuar z. zëvendësministër. Projektligji për ushqim është në vazhden e projektligjeve të mira që ka proceduar Ministria e Bujqësisë në Kuvend duke pas në konsideratë që ky Projektligj ofron një bazë të mirë ligjore në rregullimin e kësaj materie tejet të ndjeshme duke u afruar shtrirje në tërë rrjetin zinxhiror nga prodhimi, përpunimi, deponimi dhe tregtimi ushqimit për njerëz dhe kafshë. Duke pas parasysh sferën që ka për objekt ky Projektligj sigurohen qytetarët e Kosovës se ushqimi që qarkullon në vend është i sigurt, atëherë përpara kemi një projekt që ka rëndësi fundamentale për shëndetin e qytetarëve të vendit dhe për ekonominë e Kosovës në përgjegjësi. Në përmbajtje ky Projektligj është mjaft konciz krijon obligime dhe kompetencë autoriteteve përkatëse që kjo sferë të vijë në kuadër të rregullave dhe standardeve ndërkombëtare. Me këtë rast duhet theksuar që vihet në pah se implementimi i këtij Projektligji nuk krijon ngarkesë për buxhetin e Kosovës, pra nuk ka implikime financiare, çka është një element shumë pozitiv që duhet theksuar në këtë rast. Normalisht se në kuadër të lëshimeve eventuale që i hasim në këtë projekt në kuadër të kapitullit X, XI dhe XII të cilat lëshime do të evitohen gjithsesi gjatë procedurës së amendamentimit. Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim Projektligjin për ushqimin. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Lulzim ju faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Afrim Arzuallxhiu. Urdhëroni Afrim.

DEPUTETI AFRIM ARZUALLXHIU

Faleminderit. I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra prezent, kolegë të nderuar.

Grupi Parlamentar i PKD ka analizuar Projektligjin për ushqim dhe konsideron si shumë të rëndësishëm nxjerrjen e këtij Ligji. Mendojmë se në parim ky Projektligj mund të aprovohet me vërejtje që do të pasojnë. Përkundër rregullimit të kësaj çështjeje deri më tani në mënyrë indirekte përmes disa ligjeve të miratuara në Kuvendin e Kosovës dhe të Ligjit për mbrojtjen shëndetësore të artikujve jetësor të vitit 78 ka ekzistuar nevoja për një ligj të tillë unik për rregullimin e çështjes së ushqimit i cili si i tillë do të jetë në harmoni me standardet e Bashkësisë Evropiane dhe do të mund të implementohet në rrethana të reja e pronësisë private dhe ekonomisë së tregut të lirë. Mendojmë se me aplikimin e këtij ligji do të krijohen mundësitë për të realizuar qëllimin kryesor që të hartohet korniza ligjore me parimet e përgjithshme për një ushqim më higjienik, më kualitativ dhe më të sigurt për qytetarët e Kosovës. Me këtë ligj pra ka mundësi që të rregullohet kualiteti apo cilësia e ushqimit që prodhohet, përpunohet, importohet, tregtohet dhe konsumohet në Kosovë. Të gjithë e dimë se fatkeqësisht tregu i Kosovës për momentin ende është eldorado për produkte jo kualitative ushqimore për shkak të mungesës së ligjeve dhe kontrollit të duhur. Me qenë se Kosova për momentin dikur 80-85% të nevojave për produkte ushqimore i realizon nga importi është me rëndësi të jashtëzakonshme rregullimi i kontrollit të kualitetit të produkteve të importuara ushqimore. Këtë po e them për shkak të eksperiencës së hidhur që kam nga praktika me që se vijë nga industria ushqimore ku kemi pas mundësi që në laboratorët tona të bëjmë analizat fiziko - kimike të prodhimeve të konkurrencës sonë nga importi, në shumicën e rasteve kemi has në produkte që nuk plotësojnë as për së afërmi kushtet e deklaracionit shumë raste me afat të falsifikuara me aciditete shumë mbi nivelet e lejuara dhe jashtë standardeve e të mos flasim për rreziqet tjera baktirologjike.

Mendoj se duhet themeluar urgjentisht institucionet e mirëfillta për kontrollin e produkteve ushqimore me themelimin e agjencionit për ushqim dhe veterinar, laboratoriumeve të autorizuara dhe laboratoriumeve referente siç është paraparë me këtë projektligj do të krijohen mundësi të kontrollit më rigoroz të produkteve ushqimore e sidomos atyre që importohen. Po përsërisë, sidomos të atyre që importohen sepse për derisa prodhuesit apo përpunuesit vendor mund të kontrollohen në mënyrë permanente përmes inspektorëve për prodhuesit e produkteve ushqimore të importuara nuk ka kurrfarë informate për kushtet e prodhimit të prodhuesit. Vërejtja kryesore në këtë Projektligj është në ndarjen e kompetencave dhe detyrave mes inspektorateve. Mendoj se ka përzierje të kompetencave të inspektorateve. Inspektoratit sanitar i janë dhënë kompetenca të tepërta, kompetenca që mendoj që i takojnë Inspektoratit fitosanitar, p.sh. inspektimi, kontrollimi dhe përcjellja e proceseve teknologjike të përpunimit të brumërave, lëngjeve të birrës nga malti, verërave, alkoolit përpunimit të ekstrakteve etj. Me qëllim të gjetjes së formës më adekuate të ndarjes së kompetencave dhe përgjegjësisë në kontrollin e kualitetit të ushqimit në mes të inspektorateve mendoj se do të ishte e mirëseardhur edhe mendimi, vërejtjet e sugjerimet e Komisionit për Shëndetësi në këtë aspekt ose puna e përbashkët e të dy komisioneve rreth këtij Projektligji. Ky Projektligj pra mund të aprovohet në parim kurse vërejtjet tona konkrete në këtë Projektligj, me kontributin tonë dhe përmirësimet do t'i japim në komisionet funksional. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT NEXHAT DACI

Afrim ju faleminderit. Ymer Halimi në emër të AAK-së. Urdhëro Ymer.

DEPUTETI YMER HALIMI

Faleminderit z. kryetar. Të nderuar deputetë. Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural parasheh të heq një boshllëk ligjor që është në Kosovë dhe me Projektligjin për ushqimin normal sistemin e kontrollit për ushqimet e sigurta cilësore sipas standardeve ndërkombëtare. Grupi Parlamentar i AAK-së e ka mirëpritur këtë projektligj dhe ka shqyrtuar me mjaft kujdes dhe në parim e mbështet për procedim në Kuvend. Edhe përkundër përpjekjes së hartuesit që ky projektligj të jetë pa lëshime, megjithatë ka disa që ne në vijim do t'i cekim. Projektligji nuk është gjithëpërfshirës, sepse nuk trajton edhe ushqimin e insekteve, kurse bletarinë fare nuk e trajton, pranë fjalës agjenci a është më e drejtë të përdoret edhe shkurtesa për agjencinë. Agjencia si e tillë duket se është i përzier mes sektorit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Bujqësisë, përkatësisht Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, por barra më e madhe bie mbi Ministrinë e Shëndetësisë si përgjegjëse e shëndetit publik. Gjuhësisht nuk është në nivelin e duhur, sepse në disa raste tërësisht humb kuptimi thelbësor për shkak të përkthimit joprofesional. Për shembull, thuhet ushqimi i ri që duhet të jetë prodhimi i ri apo produkti i ri i ushqimit. Pastaj te neni 19.2. shkruan, për shëndetin e konsumatorit të fundit, e cili është konsumatori i parafundit, kjo nuk është humane. Në mënyrë të përsëritshme dhe pa vend përdoren termat: gjurmimi, hazard, aferon. Te neni 24.2 duhet të parashihet edhe inspektori i rrezatimeve radiologjike, kurse kapitulli IX titullin e ka jo të kuptueshëm. Dispozita ndëshkimore janë të arsyeshme. Grupi Parlamentar i AAK-së do të japë kontributin e vet me amendamente gjatë punës në komisione. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Ymer ju faleminderit. Fatmire Mulhaxha-Kollçaku

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU

Faleminderit. Ne sot në rend dite e kemi një Ligj me të vërtetë të një rëndësie të veçantë që është Ligji për ushqim. Se sa është e nevojshme me raste të caktuara të bëhet shqyrtimi i një Projektligji paraprakisht edhe prej komisionit funksional dëshmon edhe vetë kërkesa e dalë nga takimi i kryetarëve të komisioneve me Kryesinë e Kuvendit ku është shtruar nevoja që edhe para ardhjes në lexim të parë disa prej projektligjeve të shqyrtohen në parim edhe prej vet komisionit. Prandaj ne kemi has në një ligj të tillë ku komision jonë e ka shqyrtuar Projektligjin për ushqim sepse ka pa disa prej mangësive e njëra prej tyre është nevoja e madhe e amendamentimit edhe e vet Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale të këtij Projektligji. Këtu flas edhe në cilësinë e kryetares së Komisionit sepse është një kërkesë e Komisionit që në amendamentimin e

këtij Projektligji të marrinë pjesë së bashku dy komisione, do të thotë, Komisionit për Bujqësi ti bashkëngjitet edhe Komisioni për Shëndetësi.

Vërejtjet që i kam edhe si deputete janë se: në rend të parë ky Projektligji parasheh themelimin e agjencisë kosovare të ushqimit dhe të veterinarisë, mendoj që në titull është bërë gabimi sepse agjencia duhet të jetë Agjencia kosovare e ushqimit. Agjencia duhet të themelohet nga Qeveria dhe t'i përgjigjet direkt Qeverisë ndërsa duhet të jetë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Shëndetësisë, Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe institucioneve relevante. Habit fakti se në shumë vende është lënë shumë anash edhe Instituti Kombëtar që për momentin është njëri ndër institucionet më të thirrura për analizën e ushqimit. I lehet një mundësi mandej agjencionit t'i udhëzojë, mandej edhe t'i formojë laboratorët referente dhe atëherë ai t'i caktojë se kush do ta bëjë ndërsa ne veç i kemi ekspertët, i kemi kryer analizat, domethënë nuk shfrytëzohen sa duhet ai infrastruktura ekzistuese dhe ekspertë të cilët deri tani janë trajnuar.

Duke u nisur edhe prej shumë mangësive tjera ku tash njëra ndër to është se shpeshherë në projektligjet tona ka raste kur janë me atë sistemin copi – paste, mirëpo hekën atëherë edhe çështjet më të nevojshme të atij projektligji. Unë edhe një herë i thërras deputetët që ta përkrahin mendimin tonë sepse ne nuk do ta kthejmë në parim mu për shkak mendimit se nuk propozojmë që të kthehet në parim sepse është një rëndësie të veçantë dhe propozojmë që të aprovohet dhe mendimi i komisionit tonë që të bëjmë amendamentimin së bashku me Komisionin për Bujqësi. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Fatmire faleminderit, në emër të Grupit 6+ z. Rifat Krasniq. Urdhëroni.

DEPUTETI RIFAT KRASNIQ

Faleminderit z. kryetar. Unë në emër të Komisionit Parlamentar...

Sayın Meclis Başkanı, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

Tarımcılık ve Çevre Komisyonu, Beslenmeye ait Yasa Tasarısını memnuniyetle karşılamakta ve bu tasarımı hazırlayan Tarımcılık Bakanlığına teşekkürlerini sunmaktadır. Her toplumda beslenme, normal yaşamın temel standardını oluşturmaktadır, oysa Kosovada hemen her gün bu alana ait sorunlarla karşılaşmaktayız. Bundan ötürü de toplumumuz, Avrupanın birkaç ülkesinde beliriveren kuş gribi salgınının yaygınlaşmasından sonra oldukça dikkatli olmalıdır. Hiç kuşkusuz ki bu yönde, sözkonusu Yasanın uygulanmasının olumlu etkisi olacak, bunun için de bu Yasanın toplumumuz için büyük önemi vardır. Böylece benim yönetmiş olduğum Komisyon, Sağlık Komisyonu ile birlikte, sözkonusu Yasa Tasarısını tamamlamak için bu alana ait profesyonel kişiler tarafından gelen uyarılar ile önerilerden faydalanarak elinden gelen çabayı sarfedecektir. Aynı zamanda ben, Tarımcılık Komisyonu ile işbirliği yapmak isteyen ilgililere de çağrıda bulunuyorum.

Finansi konusundan söz edildiğinde, bu Yasa, onaylandıktan sonra gelen zamana bağlıdır, çünkü gerekli olan araçlar, Yasanın uygulanmaya başlaması sırasında sağlanmalıdır. Bundan ötürü de bu konu, sözkonusu Yasa onaylanmadan önce Bütçe Komisyonu tarafından bir kez daha görüşülmelidir. Diğer hatalar ise, bu Yasa Komisyonunda görüşüldüğü sırada giderilmiş olacaktır.

Teşekkürler, faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Rifat të faleminderit. Behxhet Brajshori, le të përgatitet Shpresa Murati.

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI

Faleminderit z. kryetar, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë. Unë e përshëndes punën që ka bërë Ministria e Bujqësisë dhe na ka sjellë një ligj i cili është i rëndësishëm së veçantë që ka të bëjë pra me kontrollin e cilësisë së ushqimit dhe me aspekte të tjera të rregullimit të kësaj fushe. Po ashtu, e përshëndes për një aspekt tjetër në veçanti sepse ky ligj bën të mundur edhe realizimin e një fondi të caktuar të të hyrave buxhetore të cilat do të ndihmojnë jo vetëm në implementimin e suksesshëm të ligjit por do t'i ndihmojnë edhe në aspekte të tjera, do të thotë të buxhetit konsoliduar të Kosovës, gjë që ligjin e bënë më specifik karshi disa ligjeve të tjera. Unë do të doja që një praktikë të tillë, sa të jetë e mundur, gjithmonë të parashihet edhe në rastin e hartimit të ligjeve, sepse edhe ashtu një numër i caktuar i ligjeve të cilat po miratohen në Kuvendin e Kosovës, pikërisht për shkak të mungesës të mjeteve buxhetore po mbesin të paimplementuara në vazhdim. Ne do të japim kontributin tonë në kuadër edhe të Komisionit për Buxhetor, por edhe si deputetë, me qëllim që ky ligj të fillojë sa më shpejtë së implementori dhe të konsolidohet e të rregullohet një fushë shumë e rëndësishme sikur që është kontrolli i cilësisë së ushqimit. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Behxhet, ju faleminderit. Shpresa Murati dhe të përgatitet i fundit Naim Jerliu. Urdhëroni Shpresë.

DEPUTETJA, SHPRESA MURATI

Poštovani predsedniče, poštovana Vlado i kolege poslanici, Nacrt zakona o hrani je jako značajan zakon kojim se uređuje kontrola kvaliteta hrane, higijena i zdravstvena ispravnost hrane, odnosno važna sigurne hrane za zdravlje ljudi i zdravlje životinja kao i za očuvanje javnog zdravstva uopšte na Kosovu. Usvajanjem ovog zakona eliminisaće se i postojeća pravna praznina iz ove oblasti i upotpuniti zakonska infrastruktura o hrani shodno međunarodnim standardima o hrani. U načelu mi nemamo primedbe na sam srž sadržaja Nacrta zakona o hrani zato što pre svega smatramo da isti ispunjava uslove koji su neophodni za jedan zakon ovakve prirode. Ovim zakonom se regulišu sigurnost hrane

u svim fazama proizvodnje, prerade, distribucije, ispitivanja sirovina životinjskog i biljnog porekla, kao i istraživanja bilo koje materije koja je namenjena kao sastojak hrane, zatim deklarisanje hrane, službena kontrola hrane, inspekciski nadzor kao i obaveze i ovalaščenja inspektora. U cilju zaštite ljudskog zdravlja vrši se i analiza rizika to jest mogućeg štetnog uticaja hrane po ljudsko zdravlje. Na izradi ovog Nacrta zakona učestvovali su mnogi domaći i međunarodni stručnjaci, a korišćena su iskustva zemalja u regijonu, recimo zakon o hrani Slovenije i Hrvatske. S toga parlamentarna grupa 6+ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona i daće svoj doprinos u toku njegove dalje skupštinske procedure kojom će građani Kosova dobiti još jedan savremeni zakonski dokument sprovodljiv u praksi savremenog Kosova. Hvala !

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Shpresa të faleminderit dhe ju kërkoj falje që kisha informatë të gabueshme që Rifat Krasniq do të paraqitet në emër të grupit, prandaj pranoni faljen time. Naim Jerliu. Urdhëroni Naim.

DEPUTETI NAIM JERLIU

Faleminderit z. kryetar, të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar dhe kolegë deputetë. Unë mbështes miratimin në parim të këtij projektligji ashtu siç u tha edhe nga përfaqësuesi i grupit parlamentarë edhe nga kolegët e tjerë që diskutuan. Ndërkaq do të dëshiroja të veçoja me këtë rast diçka që edhe nga prizmi të cilit anëtar të Komisionit për Shëndetësi më shtynë të theksoj ashtu siç e përmendi kryetarja e Komisionit. Ky projektligj ka të bëjë me një çështje, që është një çështje ndërsektoriale dhe mendoj se do të jetë e domosdoshme që shqyrtimi i mëtejme edhe amendamentimi i këtij projektligji të bëhet bashkërisht, përveç Komisionit për Bujqësi të merr pjesë edhe Komisioni për Shëndetësi. Unë do të theksoja në veçanti vërejtjet të cilat vijnë sidomos nga profesionistët e lëmit të shëndetësisë publike për kapitullin XI që ka të bëjë me themelimin e agjencisë kosovare të ushqimit dhe të veterinarisë siç thuhet në projektligj, dhe vërejtja e parë është pikërisht tek emërtimi i kësaj agjencie, por duke vazhduar me nene tjera. Prej nenit 36 deri 41 rregullimet që bëhen në këto nene janë shpesh kundërtënëse dhe unë do të theksoja se ky rregullim i mbikëqyrjes së funksionimit të këtij agjencionit duhet të jetë totalisht në përputhje me rregullimet që ekzistojnë në vendet në të cilat siç është thënë në memon që na është dërguar në projektligj janë mbështetur gjatë hartimit të këtij projektligji, është fjala për ligjet që funksionojnë në Slloveni , Kroaci dhe konsulenca që kanë marrë nga përfaqësuesi apo konsultanti nga Belgjika. Mendoj se në këtë mënyrë do ta bëjmë një ligj që do të jetë në përputhje me politikat e vendosura të Unionit Evropian në librin e bardhë të sigurimit të ushqimit edhe do të kemi mundësi që në këtë mënyrë ta bëjmë hapin konkret që të bëjmë legjislacion në përputhje me legjislacionin e Unionit Evropian. Faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, NEXHAT DACI

Naim ju faleminderit. Ju ftoj që ta mbështesim në parim projektligjin.

Përgatitemi për të votuar dhe votojmë tani:

74 deputetë janë **pro** aprovimit të ligjit në parim, prandaj konsideroj që është aprovuar ligji dhe më lejoni t'ju përkujtoj që në bazë të Rregullores, Kuvendi ngarkon këto komisione: Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinorë si komision funksional dhe referues dhe në bazë propozimeve dhe diskutimeve në Kuvend. Komisioni për Shëndetësi do të konsiderohet si komision funksional bashkë me komisionin e përmendur Komisioni për Gjyqësi dhe e tjera Komisioni për Buxhet dhe Komisionet për Komunitete. Prandaj ju faleminderit dhe pauza deri në ora 13,00 pastaj vazhdojmë punën. Ju faleminderit.

Pauza deri në orën 13,00.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Të nderuar deputetë. Jam i obliguar t'ju informoj për shkak të procedurës, sepse dy ligje që janë në radhë për t'u shqyrtuar, nuk do të shqyrtohen për shkak se ministri nuk ka ardhur edhe pse ishte i obliguar të vinte.

Nuk ka të drejtë zëvendësministri ta paraqesë ligjin. Qeveria e ka dërguar ministrin, në qoftë se Kuvendi mund të marrë vendim, është tjetër. Të mësohemi t'i respektojmë institucionet. Nuk besojmë së është i sëmurë z. Haraqija, prandaj është dashur të vinte në Kuvend ta paraqiste ligjin. Në qoftë se ka mendim tjetër nga grupet parlamentare, unë do ta respektoj mendimin e shumicës, por për mua si kryesues sot ky është injorim i këtij kuvendi nga ana e z. ministër. Shkresa ka ardhur në emër të Qeverisë. Ajo e ka autorizuar ministrin dhe ne nuk kemi ndonjë kërkesë tjetër për ta zëvendësuar ministrin në shqyrtimin e Projektligjit. Duhet ta kenë të qartë edhe ministrat që në përjashtim të zëvendësministrit të bujqësisë që luan edhe rolin e ministrit, të tjerët në Kuvend nuk mund të zëvendësohen me zëvendësministra. Ata mund t'i zëvendësojnë ministrat në mbledhjet e Qeverisë kur ministri nuk është i pranishëm në Kosovë, ose kur është i zënë me ndonjë punë tjetër më të rëndësishme dhe merret një vendim i tillë, ose kur e dërgon ministri për ta zëvendësuar në ndonjë takim, por në Kuvend besoj se nuk është në rregull të veprohet kështu.

Po vazhdojmë me pikën e 8- të rendit të ditës. Mendoj se lidhur me këtë duhet t'i japim mundësi që nesër në orën 10,00 ta vazhdojmë procedurën me miratimin e dy ligjeve të propozuara.

Vazhdojmë me procedim të pikës së 8- të rendit të ditës.

8. Shqyrtimi i propozim vendimit për fillimin e procedurës për hartimin e Projektkushtetutës së Kosovës.

Konstatime: Kryesia e Kuvendit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 1 nëntor 2005 shqyrtoi nismën e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës për hartimin e Kushtetutës së Kosovës dhe lidhur me këtë nxori këtë:

Përfundim

Kryesia i propozon Kuvendit që të marrë vendim për fillimin e procedurës për hartimin e Kushtetutës së Kosovës. Kryesia i propozon Kuvendit t'i ngarkojë Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, Zyrën Ligjore të UNMIK-ut dhe ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë ta fillojë përgatitjen për hartimin e Kushtetutës së Kosovës.

Lidhur me këtë propozoj të hapim debat duke filluar nga kryetarët e grupeve parlamentare me radhë dhe pastaj të shohim se a ka nevojë të bëhet debat më i gjerë lidhur me këtë çështje apo e lëmë vetëm me kryetarët e grupeve parlamentare. Do të kërkoja një deklaram me anë të votimit, që a do të hapim debat në Kuvend, që do të përfshinë të gjithë ata që janë të interesuar të diskutojnë për këtë çështje meqë është një propozim për t'ia kaluar çështjen komisionit përkatës, ta përkufizojmë me fjalën e kryetarëve të grupeve parlamentare, do të thotë ta fillojmë votimin dhe propozoj ta lëmë në nivel të grupeve parlamentare sot.

Edhe një herë po e përsëris vendimin e Kryesisë për ta ngarkuar Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës dhe me Zyrën Ligjore të UNMIK-ut me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë të fillojë hartimi i Kushtetutës së Kosovës. Lidhur me këtë kërkohet një deklaram i Kuvendit. Ne jemi të obliguar të hapim debat në Kuvend për këtë çështje dhe mendoj që sot përderisa deri sa nuk vjen projekti debati të përkufizohet vetëm në kuadër të kryetarëve të grupeve parlamentare, d.m.th mendimin në emër të grupeve parlamentare ta thonë kryetarët ose jeni që të hapet një debat lidhur me këtë çështje nga të gjithë deputetët dhe pastaj të vazhdojë, d.m.th kërkohet të deklarohemi a jemi për fjalën e kryetarëve të grupeve parlamentare, apo dom debat të hapur.

Votojmë për variantin e parë, deklarimin e kryetarëve të grupeve parlamentare në emër të grupeve të tyre.

Fjalën e kërkon z. Sabri Hamiti

DEPUTETI, SABRI HAMIT

Z. kryesues, çështja është shumë e madhe, shumë e rëndësishme, iniciativa për hartimin e një kushtetute të Kosovës. Mendoj se ju jeni në fazën e procedurës sot, kjo ka ardhur në rend dite dhe tash është fjala për procedurën. Mua më duket se nuk është e arsyeshme paraprakisht të votojmë se a do të bisedojmë për këtë iniciativë apo jo, le të shkojë sipas rregullit, le të deklarohen se edhe ashtu e kanë atë të drejtë dhe ai është rendi. Kryetarët e grupeve parlamentare për këtë iniciativë dhe ne do t'i shohim ato mendime të përmbledhura se çka thonë ata dhe a do të hapim debat apo jo më tutje. Mendoj se nuk është mirë të votojmë paraprakisht a do të hapet debat apo jo, se ne paraprakisht as që dimë se çka do të ofrojnë grupet parlamentare nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Mendimin tim nuk dua ta shfaq thashë, por thash të shkohet me rend, le të deklarohen kryetarët e

grupeve parlamentare dhe pastaj ta shohim se a kemi nevojë të bëjmë debat apo jo. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Ju faleminderit z. Hamiti

Sipas radhës është paraqitur Grupi Parlamentar i LDK-së dhe për këtë do ta japë mendimin z. Alush Gashi.

DEPUTETI, ALUSH GASHI

Faleminderit z. kryesues.

Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet iniciativën për hartimin e Kushtetutës së Kosovës dhe kërkon formimin e komisionit të posaçëm për hartimin e saj, d.m.th kërkojmë komision të posaçëm, jo komision që merret me çështjet të përditshme legjislative. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Ju faleminderit z. Gashi

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së z. Jakup Krasniqi

DEPUTETI, JAKUP KRASNIQI

Po ashtu edhe Grupi Parlamentar i PDK-së e mbështet iniciativën për fillimin e hartimit të Kushtetutës së Kosovës, por duhet ta tërheq vëmendjen në këtë rast për deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Kosova tani e ka një grup negocimi dhe aty përfaqësohen edhe subjektet politike po ashtu edhe institucionet e Kosovës dhe Grupi Negociator e ka të formuar një grup politik strategjik që mendon të formohen nën komisione për hartimin e dokumenteve përkatëse. Aty sigurisht do të jetë edhe një nën komision për hartimin e Kushtetutës që do të përbëhet nga ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë dhe nëse Kuvendi i Kosovës e formon një grup të posaçëm për ta filluar hartimin e Kushtetutës së Kosovës, mos po kemi dyfishim dhe përzierje të kompetencave, sepse kështu krijohen probleme të reja. Mendoj që Kuvendi i Kosovës dhe Kryesia është dashur këtë çështje ta kenë parasysh, sepse edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës është anëtar i Grupit Negociator Mendoj se kjo çështje nuk është trajtuar mirë në Kryesinë e Kuvendit dhe se për këtë çështje duhet të hapet një debat më i gjerë.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Ju faleminderit z. Krasniqi.

Fjalën e ka, në emër të AAK-së Gjylnaze Sylja

DEPUTETJA, GJYLNAZE SYLA

Ju faleminderit z. kryesues.

Iniciativa e Grupit Parlamentar të AAK-së ka ardhur në momentin kur nga ne kërkohet një avancim i bazës kushtetuese dhe në kohën kur i duhet Kosovës një kushtetutë, është përditshmëri dhe një përgjegjësi që kërkon punë serioze nga të gjithë ne. Arsyeja pse e kemi nisur në Kuvendin e Kosovës është se pikërisht Kuvendi është vendi ku duhet të hartohet Kushtetuta. Ne jemi në një periudhë, në një proces ku po definohet statusi i Kosovës, prandaj Kushtetuta duhet të jetë e gatshme. Gjithashtu ajo do t'i ndihmojë Grupin Negociator. Pra e shohim si përkrahje të Grupit Negociator për qëllimin për të cilin edhe është krijuar, kështu që qëndrimi i Grupit Parlamentar të Aleancës është që kjo të fillojë dhe të bëhet në Komisionin për Legjislacion, që është kompetent ashtu si e kemi cek edhe në arsyetimin tonë. Konsiderojmë se sot nuk ka nevojë të votohet, sepse nuk e kemi dokumentin dhe qëndrimi i Aleancës është të arrihet konsensusi i plotë për këtë dhe pastaj dokumenti t'i dërgohet Kuvendit dhe të votohet. Shpresoj se deputetët do ta mbështesin iniciativën e Grupit Parlamentar dhe njëkohësisht i falënderoj kolegët e mi dhe Grupin Parlamentar të LDK-së për përkrahjen. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Ju faleminderit.

Grupi Parlamentar 6+ ka ndonjë mendim ju lutem, fjalën e ka z. Jakcillar

MAHİR YAĞCILAR

Sayın Başkan Vekili, Değerli Milletvekilleri

6 + Parlamento gurubu adına görüşlerimizi iletmek istiyorum. Prensipite yeni Anayasa'nın hazırlanması için desteğimiz vardır. Yanlız Sayın Krasniçi'nin de uyardığı gibi, şu anda hem Meclis çalışmaları var, ama aynı zamanda Müzakereler ekibinin de çalışmaları var. Ve burda bir çelişkili duruma gelmememizi veya gelmemeyişimizi düşünmeliyiz. Her nasıl olursa olsun, prensipite Anayasası'nın hazırlanması için desteğimizi sunuyoruz ve burada da mutlaka bu ekipte veye kurulacak olan bu gurupta 6+ Parlamento gurubu adına da temsilcilerin yer alması bizim şartımızdır.

Teşekkür ederim

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Faleminderit z. Jagcilar

Fjalën e ka Teuta Sahatçija në emër të Grupit Parlamentar Ora.

DEPUTETJA, TEUTA SAHATQIJA

Faleminderit z. kryesues. Të nderuar deputetë, i nderuari ministër. Grupi parlamentar Kushtetutën e Kosovës e sheh si çështje shumë të rëndësishme. Kushtetuta ka rëndësinë madhore, sepse secili qytetar duhet ta përkrahë atë Ne e dimë se sot në Kuvend nuk e kemi ndonjë përfaqësim të madh prej të gjitha partive e sidomos prej pakicave. Kushtetuta kërkon një konsensus të të gjithëve. E dimë së Kushtetuta gjithashtu duhet të jetë një çështje mbipartiake, çështje më madhore duke e pasur parasysh rëndësinë që ka. Gjithashtu dimë së Kosova tash hyn në një proces jashtëzakonisht të trëndësishëm. Pra janë formuar grupe pune që do të merren me të gjitha çështjet siç e shprehu edhe kolegu im Jakupi, do të jenë grupe pune që do të punojnë edhe në këtë çështje. Në këto grupe pune do të përfshihen ekspertë që do të merren me këtë. Përveç asaj edhe një çështje teknike, sepse ne në Rezolutën që miratuam më nëntor 17 në pikën 3 të Rezolutës, obligohet Kuvendin ta përkrahë dhe që ta hartojë këtë kushtetutë në parim sipas standardeve më të larta, prandaj mendoj se votimi për këtë tashmë është bërë, d.m.th Kuvendi e ka dhënë fjalën që hartimi i Kushtetutës duhet të fillojë. Përveç asaj në këto grupe pune në Ekipin Negociator do të bëhet fjalë dhe hartimi i Kushtetutës me ndihmën edhe të ekspertëve vendorë dhe të huaj, ai dokument do të vijë gjithsesi në ratifikim nga Kuvendi, prandaj mendoj që duhet ta kemi parasysh këtë dhe të mos formojmë dy ekipe të ndryshme të cilat do të punojnë në dy drejtime, po ashtu të ndryshme. Mendoj së Grupi Negocius tashmë duhet të merret edhe me këtë çështje duke pasur parasysh se ne po hyjmë në këtë proces. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Ju faleminderit z. deputete.

Mendoj së sipas kërkesave që ishin, të gjitha grupet parlamentare u deklaruan dhe konstatimi im është që nuk ka qëndrim unik lidhur me këtë. Sipas procedurës duhet të interpretohet mundësinë e dhënies ose e marrjes së vendimit për këtë. Fjalën e ka Fatmir Sejdiu që është paraqitur edhe si anëtar i Kryesisë edhe si një ndër ata që mund të flas me kompetencë lidhur por në qoftë se nuk hapet debati atëherë jam i detyruar ta shtyjmë këtë pikë të rendit të ditës për ndonjëherë tjetër.

Fjalën e ka Fatmir Sejdiu

DEPUTETI, FATMIR SEJDIU

Faleminderit z. kryesues.

Unë nuk do të ndalem shumë në çështjet e procedurave, sepse fund i fundit është edhe pjesë e ekipit që do të ndihmojë në këtë, por do ta jap edhe mendimin tim në këtë drejtim.

E para është se u shpreh edhe nga kryetari i Grupit të LDK-së dhe mendoj se ishte e përputhshme çështja e kësaj iniciativës që të fillojmë me nismën e hartimit të Kushtetutës së Kosovës. Çështja e dytë çka atë bëhet. Unë mendoj se u tha edhe nga disa

të tjerë, është një akt i veçantë dhe natyrisht me peshë që ka kërkon një përkushtim po ashtu të veçantë të Kuvendit dhe lidhur me këtë mendoj se Kuvendi ka për detyrë të marrë vendim të veçantë për formimin e ekipit që do të merrej vetëm me hartimin e Kushtetutës së Kosovës. Kjo ka të bëjë nga përvojat normale që kanë edhe vendet e tjera në hartim të këtij akti. U theksua çështja e grupeve të punës ose të ekipeve që janë karshi Ekipit Negociator, mendoj se është një proces tjetër që ka të bëjë me një vazhde bisedimesh, por nuk ka të bëjë me hartimin e Kushtetutës. Në këtë bazë është shumë me rëndësi që pjesa e atyre ekipeve të ndahet në atë që ka të bëjë me interpretimin e bisedimeve që pastaj të vijë në Kuvend, pra unë nuk do ta zgjas më tepër dhe Kuvendi mund ta pranojë iniciativën si të tillë. Në fazën tjetër të kërkohet nga grupet parlamentare, por edhe një përgatitje të përbashkët të Kryesisë me shefat e grupeve parlamentare që të formohet ekip që do ta hartonte fazën tjetër të kushtetutës. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Ju faleminderit. Atëherë nuk është hapur debati dhe mendoj se mendimi i fundit për t'i hapur rrugë hyrjes në proces të votohet dhe ta kalojmë këtë çështje. Kryesia me grupet parlamentare pastaj t' vazhdojë negociatat dhe të punojë lidhur me këtë çështje. A jeni të mendimit të votohet dhe ju lutem teknika të jetë e gatshme për këtë.

Kush është për fillimin e kësaj procedure,? Propozimi miratohet me 70 vota për dhe pa asnjë kundër, ju faleminderit.

Konstatojmë që edhe kjo çështje, me votim unanim ka kaluar. Njëkohësisht dëshiroj që në emër tuaj dhe në timin t'i përhëndes dy deputetë të Kuvendit të Shqipërisë që morën pjesë në punimet e Kuvendit: z. Neritan Cekën dhe Piro Lutën, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë.

Fjalën e ka Z. Alush Gashi

DEPUTETI, ALUSH GASHI

I nderuar z. kryesues sa për korrektësi, ne votuam për iniciativën lidhur me hartimin dhe me atë se si duhet të veprohet, në cilin nivel mendojmë se do të jetë komision i posaçëm, prandaj presim nga Kryesia që të marrë vendim. Mendojmë se për çështjen e Kushtetutës nuk kemi mandat ta negociojmë me askënd jashtë vendit. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Unë mendoj se u hodh në votë mendimi që u tha në fund.

Vazhdojmë me pikën e 9 -të të rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit për Siguri

Kryesia e Kuvendit të Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 1 nëntor 2005 shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë për formimin e Komisionit për Siguri dhe lidhur me të nxori:

P e r f u n d i m

Me të cilin mbështetet kërkesa e Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë për formimin e Komisionit për Siguri. Nga grupet parlamentare kërkohet t'ia propozojnë Kuvendit kandidatët për anëtarë të Komisionit për Siguri ,sipas numrit të anëtarëve të deritashëm në Komisionin për Gatishmëri dhe Emergjencë.

Propozimet e grupeve parlamentare u janë shpërndarë të gjithë deputetëve si vijon.

1. Naim Maloku, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës,
2. Ylber Hysa, Ora,
3. Xhezair Murati, Grupi 6+
4. Agim Krasniqi, LDK
5. Fadil Geci, LDK
6. Sanije Zeqiraj dhe
7. Fadil Kryeziu,
8. Qibrije Hoxha,
9. Sokol Bashota, PDK
10. Emin Krasniqi,
11. Xhevat Bislimi dhe
12. Vesna Jovanoviq,

Kryetar është propozuar Naim Maloku,
Nënkryetar nga Ora është propozuar Ylber Hysa ,kurse
nënkryetar Agim Krasniqi

Dua të sqaroj edhe diçka. Grupi Parlamentar i LDK-së nuk i ka dërguar emrat për anëtarët e këtij Komisioni, prandaj administrata në marrëveshje me kryetarin i ka futur të gjithë anëtarët që kanë qenë në Komisionin për Emergjencë dhe Siguri në këtë komision. Tani kryetari i Grupit Parlamentar e ka fjalën ,në qoftë se ka diçka për sqarim.

DEPUTETI, ALUSH GASHI

Z. kryesues do t' ju lutja të jeni korrekt,sepse këtu nuk ka nevojë të falsifikohen të dhënat, as që në emër të grupit parlamentar askush nga administrata ta bëjë delegimin. Z. kryesues kemi marrë një rend dite, kemi marrë edhe një propozim për të marrë vendim për formimin të Komisionit për Siguri. Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet vendimin për formimin e Komisionit për Siguri. Ne asnjëherë në seancë plenare nuk kemi marrë vendim për shuarjen e Komisionit për Gatishmëri Emergjente, andaj përpjekjet e administratës për të udhëhequr vetvetiu Kuvendin, janë të papranueshme, nuk ka mbetur Grupi Parlamentar i LDK-së që burokratët nga administrata të na i caktojnë përfaqësuesit tonë. Ne e mbështesim iniciativën për formimin e Komisionit për

Siguri dhe kërkojmë sqarime nga Kryesia e Kuvendit që këtu në seancë plenare të shpjegojnë se kur është marrë vendimi për shuarjen e Komisionit për Gatishmëri Emergjente. Në momentin kur të kemi sqarim për formimin e Komisionit për Siguri do t'i japim me kënaqësi të posaçme emrat e kandidatët për atë komision, për të cilin mendojmë se është i një rëndësie të posaçme. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Ju faleminderit z. kryetar i grupit parlamentar. Do t'i kem parasysh vërejtjet. Fjalën e ka z. Fatmir Sejdiu.

DEPUTETI, FATMIR SEJDIU

Faleminderit z. kryesues.

Kjo çështje është shtruar në Kryesinë e Kuvendit. flas në dy cilësi si përfaqësues i LDK-së dhe si anëtar i Kryesisë dhe ka pasur mendime të ndryshme dhe gjithashtu Kryesia e Kuvendit nuk ka marrë vendim që të shuhet një Komision dhe të formohet Komisioni tjetër, ka pasur ide, por Kuvendi është ai që shuan një Komision dhe merr vendim për formimin e Komisionit tjetër. LDK-ja nuk ka dërguar asnjë propozim, propozimet tona do të bëhen pasi të merret vendimi që të formohet Komisioni i ri sipas propozimit tonë apo Kuvendi nëse vendos që të formohet të bëhet shuarja e atij komisioni e më pastaj të formohet komisioni i ri. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Ju faleminderit

Mendoj se mjafton kjo nga LDK-ja. Në qoftë se kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së ka diçka për të thënë, lë të urdhërojë.

DEPUTETI, JAKUP KRASNIQI

Unë e përshëndes kërkesën e shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së që vendimet që merren në Parlament me votën e deputetëve të konsiderohen dhe të jenë vendime të Kuvendit dhe jo të bëhen vendime jashtë Kuvendit dhe të konsiderohen vendime të Kuvendit, d.m.th ne e kemi kërkuar moti këtë. Nëse ky kuvend merr vendimin për të formuar Komision të ri pa e shuar komisionin ekzistues, atëherë edhe ne do t'ia dërgojmë propozimet tona Kryesisë si të gjitha grupet e tjera parlamentare, por njëkohësisht do të kërkojmë sqarim: cili grup parlamentar do ta ketë radhën për ta drejtuar komisionin e ri dhe po ashtu mendojmë se duhet të ndërpritet praktika e marrjes së vendimeve jo vetëm për këtë çështje, por edhe për çështje të tjera jashtë Kuvendit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Ju faleminderit.

Grupi Parlamentar për Ardhmërinë e Kosovës Gjylnaze Syla

DEPUTETJA, GJYLNAZE SYLA

Faleminderit z. kryesues

Më lejoni të lexoj vendimin e Kryesisë.

Janë 4 pika të rendit të këtij përfundimi si vijon:

1. Mbështetet kërkesa e Komisionit për Gatishmëri dhe Emergjencë për ta formuar Komisionin për Siguri
2. Kërkohet nga grupet parlamentare që t'ia propozojnë Kuvendit kandidatët për anëtarë të Komisionit për Siguri sipas numrit të anëtarëve të deritanishëm në Komisionin për Gatishmëri dhe Emergjencë. Kandidatët e propozuar duhet të kenë njohuri në punën e sigurisë. Propozimet t'i dërgohen Kryesisë deri më 10 nëntor 2005.

Këtë e lexova me qëllim se edhe nëse vendimi i Kuvendit do të ishte për shuarjen e këtij komisioni dua t'ia kujtoj Kuvendit se Komisioni për Emergjencë udhëhiqet nga AAK-ja. përkatësisht nga anëtari i Kryesisë dhe deputeti i Aleancës z. Naim Maloku dhe kjo është bërë sipas votimit të kryetarëve të komisioneve në seancën plenare të Kuvendit të dt. 2 dhjetor 2004. Në qoftë se Kuvendi vendos shua këtë komision dhe me e formua Komisionin për siguri e gjithashtu ky Komision do t'i takoj Aleancës sipas rregullave në fuqi.

Në qoftë se Komisioni nuk shuhet atëherë duhet t'i zgjerohen kompetencat t'ia kujtoj Kuvendit politikën e zvogëlimit të numrit të komisioneve, ne kemi pasur 19 komisione, por janë zvogëluar në 11 sosh dhe ndoshta zgjerimi i kompetencave të Komisionit për Gatishmëri është në përputhje me politikën e Kuvendit. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Fjalën e ka z. Hysa

DEPUTETI, YLBER HYSA

Para se të vazhdohet biseda për këtë çështje, shumë me rëndësi është të njoftohemi këtu për mënyrën se si ka ndodhur kjo punë Qenë pikërisht kërkesa dhe ankesa sa jam unë i informuar e grupi më i madh parlamentar që të shuhet ky komision dhe të krijohet tjetri, prandaj edhe i kemi hyrë kësaj procedure. Ne e kemi mandatar në Komisionin tonë në emër të komisionit z. Maloku që ta shqyrtoj këtë çështje, pasi ai është ngritur dhe pasi që ne kemi pasur vonesa substanciale në punën e këtij grupi. D.m.th t'ju përkujtoj se para disa ditësh është mbajtur trajnimi i parë që është shtyrë për disa muaj për një grup aq të rëndësishëm që duhet të jetë krahas në përgatitje për bartjen e kompetencave, andaj kjo punë e ka historikun e vet të problemit- është bërë pikërisht pse disa kanë qen të pakënaqur, ndoshta në fillim kur është krijuar Komisioni për Emergjencë dhe Gatishmëri

u është dukur që është komision i zjarrfikësve. Kur e kuptuan se mund të jetë i rëndësishëm kanë filluar që të krijonin probleme, kështu që unë pajtohem me të gjitha marrëveshjet që mund t'i arrijmë këtu si grup dhe jemi të hapur për cilado marrëveshje, por është e rrugës që ta shqyrtojmë problematikën se si ka ndodhur, sepse besoj se do të ishte një luks i madh për këtë Parlament t'i ketë dy këso komisionesh, ose do të ketë një pa marrë parasysh procedurën se a duhet shuar njërin për ta krijuar një tjetër. Për këtë duhet të zhvillohet një debat që këtu nuk ka ndodhur.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Të nderuar deputetë. Mendoj se nuk ka nevojë debat më i gjerë, konstatoj së grupet parlamentare nuk janë marrë vesh as brenda vetes dhe mendoj së kjo çështje duhet të shtyhet për ndonjëherë nga seancat e ardhshme të Kuvendit pasi që të harmonizohen me Kryesinë e Kuvendit dhe uroj që vërtet të mos ndodhin këto çështje në këtë formë. Jam i obliguar të kërkoj falje në qoftë se vërtet ka pasur shkelje të procedurës.

Vazhdojmë me pikën e 10- të rendit të ditës.

10. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit Parlamentar ad-hoc për t'i rekomanduar Kuvendit anëtarët e Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave

Në mbështetje të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe me kërkesën e komisionarit të përkohshëm për media, Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka kërkuar nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës ta caktojnë nga një përfaqësues (gjithsej 17) në Komisionin parlamentar ad-hoc për t'i rekomanduar Kuvendit anëtarët e këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave sipas nenit 4 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të mediave. Propozimi i partive politike në lidhje me përbërjen e anëtarëve të Komisionit parlamentar ad-hoc për këshillin e pavarur të mediave është si vijon:

1. Fatmir Sejdiu, LDK
2. Fehmi Mujota, PDK
3. Ymer Halimi, AAK
4. Ylber Hysa, Ora
5. Mark Krasniqi, Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës,
6. Emrush Xhemajli, LPK
7. Bislim Hoti, IRDK
8. Zylfi Merxha, PREBK
9. Mahir Jakcillar, KDTP
10. Xhezair Murati, Vakati,
11. Rrustem Ibishi, GIG

Disa parti të tjera që janë të përfaqësuar në Kuvend nuk i kanë dërguar propozimet e tyre në Kryesi, por ata mund të shkojnë në procedurë të rregullt, sepse automatikisht janë edhe anëtarë të këtij komisioni;

1. Numan Baliq nga SDA
2. Gjergj Dedaj, PLK
3. Sabit Rrahmani PDAK
4. Oliver Ivanoviq, SLKM
5. Zlatica Kujungjiq, PDKM dhe
6. Ferid Agani, PD.

Këta janë anëtarët e propozuar të Komisionit.

Hap procedurën e deklarimit për ose kundër këtij komisioni. Luteni të bëheni gati për votim.

Kush është për:

Konstatohet se është miratuar propozimi i Komisionit. Kanë votuar 79 për,
6 kundër dhe
4 kanë abstenuar.

Të pranishëm janë 91 deputetë .

Në vijim kemi pikat 11 dhe 12 të rendit të ditës

- 11. Përgjigja e kryeministrit të Kosovës deputetit Ramadan Kelmendi dhe**
- 12. përgjigja e kryeministrit të Kosovës, deputetit Berat Luzha**

Kryeministri nuk është këtu, por besoj se deputetët me shkrim i kanë marrë përgjigjet dhe z. Kelmendi e ka kërkuar fjalën, sepse ka të drejtë ta shpreh mendimin e vet lidhur me përgjigjen që është dhënë nga kryeministri.

DEPUTETI, RAMADAN KELMENDI

Faleminderit z. kryesues.

I jam mirënjohës Qeverisë së Kosovës për kontributin që ka dhënë për përgjigje të pyetjes së parashtruar me shkrim që bëra unë në një kohë më përpara, me gjithë atë që kemi marrë përgjigje me shkrim. Konsideroj se çështja e Mitrovicës është çështje madhore, mjaft e hapur në kontekstin e tërësishëm të situatës në Kosovë. Kam shumë çka për të thënë por dua të them në pika të shkurtra për të mos ju munduar. Konsideroj se çështja e Mitrovicës është një çështje madhore dhe mjaft e hapur në kontekstin e tërësishëm të problematikës së situatës në Kosovë. Pra të mos ju lodhi këtu. Në Mitrovicë ndodhin gjëra për të cilat niveli qendror i pushtetit tonë nuk është i informuar sa duhet ose hesht për to. Në këtë qytet lëvizja e qytetarëve është tërësisht e ndaluar nga Jugu në Veri, ndërsa nga Veriu në Jug është shumë i shtuar dhe para syve të shërbimit policor dhe të qytetarëve bëhet ndërrimi i targave me të cilat qarkullojnë lirisht edhe me

ato të sistemit paraprak. E dyta qytetarëve shqiptarë që nuk janë numër i vogël e që janë refugjatë në qytetin e tyre,ky numër është 12.000 familjarë me 23.600 anëtarë të familjeve që u ndalohen ndërtimi dhe meremetimi i shtëpive të tyre të djegura deri në themele nga forcat serbe. Këtë e bën UNMIK-u.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Vëmendje z. deputetë e dini sa keni kohë për këtë çështje sipas Rregullores.

DEPUTETI, RAMADAN KELMENDI

Urdhëresa administrative pengon tërësisht pushtetin lokal për ta ushtruar në tërë hapësirën gjeografike të komunës së Mitrovicës dhe në veçanti. Është investuar shumë në kompleksin e Kullës së Isa Buletinit dhe atje në tërësi është uzurpuar prona e heroit tonë kombëtar, është ndalur tërësisht hyrja në këtë kompleks të kullës nga kisha ortodokse dhe atje lirisht lëvizin. Këtë e din edhe ministri dhe unë personalisht, forcat serbe që deklarohen lirisht se janë policë të shërbimit policor të një shteti tjetër, të Serbisë po ashtu në Veri është ndërtuar në pronën e shqiptarëve kisha ortodokse e cila në tërësi provokon çdo gjë që është pozitive dhe që ka karakter të bashkëpunimit. Kërkojmë që sipas kontributit që është dhënë deri sot jo të dihet se nuk ka ndarje, por të luftohet për të ruajtur unitetin e tërësisë territoriale, politike, administrative të qytetit të Mitrovicës. Kjo përgjigje me shkrim vërtet është një pjesë, por jo sa duhet dhe sa kërkohet ,sepse të gjithë që jemi këtu dikush më shumë e dikush më pak kemi manipuluar me ata qytetarë që na kanë dhënë votën dhe jemi zotuar se posa ta marrim besimin e tyre do të punojmë për çështjen e Mitrovicës dhe ne vërtetë nuk jemi duke punuar. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Ju faleminderit z. Kelmendi, kurse z. Berat Luzha ka bërë një pyetje për kryeministrin. Përgjigjen me shkrim e ka marrë, kryeministri nuk është i pranishëm,prandaj sipas procedurës unë kam obligim të pyes se a është i kënaqur me përgjigjen dhe a do të thotë diçka lidhur me këtë çështje.

DEPUTETI, BERAT LUZHA

Nuk jam i kënaqur me përgjigjen e kryeministrit. Kam edhe pyetje plotësuese të shumta që kam t'ia bëj atij. Mua më habit fakti pse ai nuk ka ardhur në seancë dhe t'u përgjigjet pyetjeve të deputetëve. Pyetjet e deputetëve janë sipas Rregullores së Kuvendit dhe janë të obligueshme për kabinetin qeveritar, mosardhja e tij dhe mos përgjigja tregojnë se Qeveria vazhdimisht e injoron Kuvendin , i injoron pyetjet e deputetëve, i injoron edhe interpelancat dhe të gjitha me radhë. Kuvendi nuk duhet të shndërrohet në një mekanizëm votues, por duhet për çdo gjë të vendoset në te .Pyetjen e kam shtruar qe 2 muaj e gjysmë dhe tash erdhi një përgjigje me shkrim e cila për mua është shumë e mangët dhe

kërkoj nga Kryesia që gjithsesi kryeministri të vijë dhe të përgjigjet në pyetjen e përshtruar. Ju faleminderit.

KRYESUESI, XHAVIT HALITI

Faleminderit z. Luzha.

Sa u përket pikave të rendit të ditës u kemi rënë në fund.

Faleminderit për bashkëpunim. Kemi dy pika të rendit të ditës që nuk janë shqyrtuar për shkak se mungon ministri i Kulturës. E kam për obligim t'ju pyes se këto dy ligje a do të kërkojmë që nesër t'i shqyrtojmë dhe ta thërrasim ministrin ,apo ta lëmë për seancën e ardhshme të Kuvendit. Ju lutem që të deklarohe mi.

Atëherë këto dy projektligje janë: Projektligji për veprimtarinë botuese dhe librin dhe ai për institucionet e kulturës që mbeten të shqyrtohen në seancën e ardhshme të radhës së Kuvendit .

Faleminderit për bashkëpunim.